

UDHËZIM
Nr.68, datë 15.3.2005

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 9.5.2003 “PËR ZBATIMIN E VENDIMIT
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.159, DATË 13.3.2003 “PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET, SI DHE PROCEDURAT E
SHITJES””**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe procedurat e shitjes”, Ministri i Ekonomisë

UDHËZON:

Pas pikës 1 të udhëzimit nr.1, datë 9.5.2003, bëhen këto shtesa:

“0.1 Miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private drejtohet dhe organizohet nga Ministri i Ekonomisë. Përrjashtimisht, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private për pasuritë e luajtshme kryhet nga organi që i administron ato.

0.2 Përkufizime

1. “Pasuritë e luajtshme” do të konsiderohen: makineritë, pajisjet, inventari ekonomik dhe mjetet e xhiros, por jo linjat e prodhimit dhe të shërbimit, si dhe aksesorët që bëjnë të pamundur funksionimin e këtyre linjave.

2. “Organi që i administron ato” do të konsiderohen:

- a) Për organet e qeverisjes vendore, konsiderohet: këshilli i qarkut, i bashkisë dhe i komunës;
- b) Për institucionet qendrore, konsiderohet: titullari i institucionit qendror.
- c) Për ndërmarrjet shtetërore të patransformuara, konsiderohet: këshilli drejtues i ndërmarrjes dhe kur nuk ka të tillë, miratimi i kalimit të pronës shtetërore në pronë private bëhet nga titullari i ministrisë së vartësisë administrative.
- d) Për shoqëritë tregtare, konsiderohet: këshilli mbikëqyrës.
- e) Për repartet ushtarake dhe komisaritet e policisë, konsiderohet: titullari i ministrisë përkatëse.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË
Anastas Angjeli